

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për krime të rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Syzana Goxhuli, si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit D.K.1., nga Prishtina, për shkak të veprës penale sulm seksual, nga neni 232 par.1 të KPRK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, av.N.A., nga Prishtina, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.675/16, të datës 13.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **14. Shkurt. 2019**, mori këtë:

AKTGJYKIM

REFUZOHET si e **pabazuar** ankesa e mbrojtësit të akuzuarit D.K.1. , ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.675/2016 të datës 13.11.2018, **VËRTETOHET**.

Arsyetim

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë PRK.nr.675/16 të datës 13.11.2018, i akuzuari D.K.1., nga Prishtina, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale sulm seksual, nga neni 232 par.1 të KPRK, dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 3.000(tremijë)Euro, e të cilin dënim është i obliguar që të paguajë në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe atë në 6(gjashtë)këste.

Nëse i akuzuari nuk mund të paguajë dënimin me gjobë i njëjti do të shndërrohet në dënim me burg, ashtu që për çdo 20 Euro, do të llogaritet një ditë burgim.

I akuzuari D.K.1., është obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale që dalin sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 Euro, dhe 50 Euro, për fondin për kompensimin e viktimave të krimit, dhe të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë.

E dëmtuara Sh. (I.) M., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Mbrojtësi i të akuzuarit D.K.1., av.N.A., nga Prishtina, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ta anuloj dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë, në rishqyrtim dhe vendosje.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, me shkresën e vet PPA.I.nr.41/19 të datës 31.01.2019, ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, ta vërtetoj.

Gjykata e Apelit e Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPRK-së shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, si dhe pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, dhe gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit D.K.1., av.N.A., aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në kuptim të nenit 384 par.1 nën par.1. 12 dhe par.2 të KPRK-se, nga arsyeja se aktgjykimi nuk përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, pastaj se provat kundërtënëse janë vlerësuar në kundërshtim me përmbajtjen e tyre dhe përshkrimi faktik i veprës penale nuk përmban fakte dhe rrethana që e përbëjnë veprën penale. Pra sipas mbrojtësit, dispozitivi i aktgjykimit përfshihet me kundërtënie në mes vete dhe arsyetimit, për shkak se është nxjerrë në kundërshtim me përmbajtjen e shkresave të lëndës, meqë kjo paraqet bazë që aktgjykimi si i tillë, nuk mund të qëndroj dhe se i njëjti duhet të anulohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore të Prokurorisë Themelore në Prishtinë lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk qëndrojnë. Aktgjykimi i ankimuar është i qartë dhe konkret, nuk përmban kundërtënie qoftë me vetveten ose me arsyetimin e tij. Në arsyetim janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike mbi të gjitha faktet relevante. Gjykata e shkallës së parë vlerësimin e provave e ka bërë në harmoni me nenin 370 të KPPRK-së, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i merr si të provuara ose të pa provuara. Gjykata e shkallës së parë ka bërë analizimin e provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në bazë të tyre ka nxjerrë konkludimet e veta të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Gjithashtu, nuk ekzistojnë as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtësi i të akuzuarit pretendon se gjatë gjykimin dhe administrimit të provave, nuk është arritur që të vërtetohet se i akuzuari D.K.1., të ketë kryer veprën penale sulmi seksual, nga neni 232 par.1 të KPRK, ngase e dëmtuara SH.M., vet është imponuar në shoqëri me të akuzuarin D.1., pa e njohur të njëjtin dhe as tre shokët e tij që ishin prezent me te, mirëpo, gjykata është bazuar vet në deklaratën e palës së dëmtuar Sh.

M., e që gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se thëniet e saj janë vetëm trillime dhe nga deklarata e saj nuk ka asgjë të vërtetë. Sipas mbrojtjes e dëmtuara, pasi që ka qenë në ndikimin e substancave narkotike dhe alkoolit natën kritike rreth intervalit kohor 02:00-03:00, me iniciativën e saj ka hipur në veturën e dëshmitarit D.K.2., dhe kanë bërë gjiron nëpër Prishtinë, së bashku me të akuzuarin D.K.1., dhe se nuk ka kërkuar në asnjë moment që ata ta ndalonin dhe ta lënin diku, pra, gjykata nuk ka arritur që të vërtetoj se i akuzuari D.K.1., të ketë kryer ndonjë veprim me qëllim të sulmit seksual ndaj tani të dëmtuarës SH.M..

Nga një gjendje e vërtetuar faktike në mënyrë të gabuar sipas mbrojtjes së të akuzuarit gjykata e shkallës së parë, gabimisht e ka aplikuar edhe ligjin penal, kur të akuzuarin D.K.1., e ka shpallur fajtor për veprën penale sulmi seksual, nga neni 232 par.1 të KPRK.

Gjykata e Apelit e Kosovës, konstaton se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, nuk janë të bazuara nga arsyet se e njëjta gjendjen faktike e ka vërtetuar përveç se nga deklarata e të dëmtuarës SH.M., edhe nga deklaratat e tjera, si dëshmitari D.K.2., foto dokumentacioni ku vërehet e dëmtuara e fotografuar me dt.24.08.2016, e ku theksohen shenja të cilat i ka pësuar tani e dëmtuara gjatë përpjekjes së të akuzuarit për sulm dhe shmangies nga tani i akuzuari, akt ekspertimi mjeko ligjor me nr.PR-704, i dt.01.11.2016, në të cilin është përshkruar se në trupin e të dëmtuarës janë vërejtur disa shenja, mirëpo, eksperti mjeko ligjor nuk ka mundur të caktoj kohën e shkakimit të këtyre shenjave, sepse kanë kaluar shtatë ditë pas ngjarjes dhe se eksperti mjekoligjor ka pranuar urdhër për ekspertim pas dy muajve.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të dëshmive të dëshmitarëve, administrimit të provave materiale dhe mbrojtësit së të akuzuarit, ka vërtetuar se i akuzuari me dashje, me dt.18.08.2016, rreth intervalit kohor 02:00-03:00, në fshatin ..., Komuna e Prishtinës, pasi ka dalë së bashku me të dëmtuarën Shqipe, nga vetura dhe posa ishin larguar disa metra nga vetura, tani i akuzuari ka filluar të prekët të dëmtuarën duke e përkdheluar me duar dhe puthur me qëllim seksual, pa pëlqimin e saj, ku nga zhurma e te demtuares dhe fjalët "ndal çka je duke ba", ka dalë nga vetura dëshmitari D.K.2., i cili e ka qortuar tani të akuzuarin me fjalët "D.1. nuk është në rregull sepse edhe ne kemi motra".

Një gjendje të këtillë të vërtetuar faktike e aprovon edhe Gjykata e Apelit, ngase e njëjta është e mbështetur në prova të cilat gjenden në shkresat e lëndës, andaj, pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, i konsideron si të pabazuara nga arsyeja se vetë e dëmtuara në shqyrtimin gjyqësor, në mënyrë precize dhe të qartë ka shpjeguar veprimet e të akuzuarit. Nga një konstatimi i këtillë i drejtë dhe i ligjshëm i gjendjes faktike, del se gjykata e shkallës së parë, drejt e ka aplikuar edhe ligjin penal, kur të akuzuarin D.K.1., e ka shpallur fajtor për veprën penale sulmi seksual, nga neni 232 par.1 të KPRK, ngase në veprimet e të njëjtit ekzistojnë të gjitha elementet objektive dhe subjektive të kësaj vepre penale.

Sa i përket vendimit lidhur mbi sanksionin penal, mbrojtësi i të akuzuarit pretendon nga arsyeja se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljet e ligjit penal, aktgjykimi duhet anuluar.

Megjithatë Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi edhe lidhur me vendimin për sanksionin penale dhe gjeti se dënimi i shqiptuar të akuzuarit me gjobë në shumë prej 3.000(tremijë)Euro, për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit dhe se me të njëjtin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK, respektivisht të parandaloj kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, si dhe të bëjë kompensimin e viktimave për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale, pastaj të ndikoj në ngritjen e moralit të shoqërisë dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.26/19, më 14.02.2019

Procesmbajtëse,
Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit,
Abdullah Ahmeti

Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi

Afrim Shala
